



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2022:113916

Datë: 16.11.2023

Numri i dokumentit: 04930624

PKR.nr.408/2022

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË /DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA, në përbërje nga trupi gjykues prej tre gjyqtarëve profesionistë, përkatësisht gjyqtari Naser Foniqi – kryetar i trupit gjykues - KTGJ dhe Alltën Murseli e Gëzim Ademi, anëtarë të trupit gjykues, me bashkëpunëtoren profesionale Arbenita Hoxha Koleci, në çështjen penale të akuzuarit S.U., i akuzuar për shkak të veprës penale Kontrabandimi me migrantë në bashkim kriminal nga neni 164, par. 1 të Kodit nr. 06/L - 074 Penal të Republikës së Kosovës - në vijim KPRK, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti i Krimeve të Rënda PP/L.nr.465/2022, të datës 01.08.2022, në shqyrtimin gjyqësor, të hapur për publikun, të mbajtur më datat 08.09.2023, 25.10.2023 dhe 10.11.2023, në të cilin ishin të pranishëm: prokurorët e shtetit Merrushe Llugiqi e Besa Limani dhe i akuzuari S.U., me mbrojtësin e tij av. Avdi B. Dinaj me autorizim, pas shqyrtimit gjyqësor, me datë 10.11.2023, mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari S.U., i biri i R. dhe B., e vajzërisë T., i lindur me datë ... në M., lagjja "...", rruga "...", numër ..., me numër personal ..., shqiptar - shtetas i Republikës së Kosovës, **ka qenë nën masën e arrestit shtëpiak nga data 01.06.2022 deri me datë 11.08.2022**,

Konform nenit 363, par. 1 nënpar. 1.3 të KPP,

LIROHET NGA AKUZA

S e p s e: është marrë me kontrabandim të migrantëve, me qëllim të përfitimit të drejtpërdrejtë apo të tërthortë të dobisë financiare apo dobisë tjetër pasurore nga hyrja e paligjshme e personave në Republikën e Kosovës, të cilët nuk janë shtetas të Kosovës, në atë mënyrë që me datë 02.06.2022 rreth orës 22:00, në fshatin M..., Komuna e Obiliqit, pas ndalimit policor nga Njësia e Trafikut Rajonal të Prishtinës, të autobusit të tipit "Mercedes" me targa ..., të cilin e drejtonte i pandehuri S.U., në brendësi të autobusit policët kanë hasur në pesëdhjetë e shtatë shtetas të huaj – prej të cilëve dyzet e tetë migrantë nga Siria, pesë nga Egjipti, njëzet nga Iraku, një nga Palestina dhe një nga Bangladeshi, të cilët i pandehuri i kishte kontrabanduar, në mesin e të cilëve ishin edhe të dëmtuarit – dëshmitarët M.S., M.K., M.A., A.M., A.Sh.H. dhe B.J., ndërsa policia në vendin e ngjarjes ka gjetur dhe sekuestruar autobusin e tipit "Mercedes" me targa ..., çelësin e këtij autobusi, një telefon Samsung A 32 me numër IMEI ..., 1300 € të holla kesh, si dhe librezën e qarkullimit të autobusit, nr. CRA ..., si sende të përdorura për

kryerjen e veprës penale si dhe sende të përfituara nga kryerja e kësaj vepre penale, të gjitha pronë e të pandehurit S.U.,-

- Pasi që, nuk është provuar se ka kryer veprën penale, Kontrabandimi me migrantë, parashikuar nga neni 164 par.1 të KPRK.
- **Të dëmtuarit: M.S., M.K., M.A., A.M., A.Sh.H. dhe B.J.,** për realizimin e kërkesës pasurore-juridike nuk udhëzohen në kontest civil sepse gjatë deklaramit të tyre në mundësinë hetuese të veçantë kanë deklaruar se nuk ndihen të dëmtuar në raport me të akuzuarin dhe nuk kërkojnë kompensim dëmi.
- **Të akuzuarit S.U., i kthehen një telefoni Samsung,** me nr. IMEI ... **dhe para në vlerë prej një mijë e treqind e njëzet (1320) euro,** të sekuestruara me urdhrin PPRKR.nr.311/2022 të datës 08.06.2022, pasi nuk është vërtetuar se janë përdorur për kryerjen e veprës penale e as përfituar me kryerjen e veprës penale si më lart.
- Shpenzimet gjyqësore bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

ARSYETIMI

Pas kallëzimit penal të Policisë së Kosovës/Departamenti i Policisë Kufitare në Prishtinë numër 2022-YI-4, të datës 02.06.2022, Prokuroria Themelore në Prishtinë/ Departamenti i Krimeve të Rënda me aktakuzën PP/I.nr.465/2022, të datës 01.08.2022, ka akuzuar të pandehurin S.U., për shkak të veprës penale Kontrabandimi me migrantë në bashkim kriminal nga neni 164, par. 1 të KPRK.

Në seancën e shqyrtimit fillestar të datës 10.08.2022, pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit, i akuzuari S.U. ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën dhe është deklaruar i pa fajshëm.

Edhe në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 08.09.2023, pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit, i akuzuari S.U. ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën dhe është deklaruar i pa fajshëm për veprën penale si në aktakuzë.

Në fillim të seancës së shqyrtimit gjyqësor të datës 10.11.2023, prokurori i shtetit ka bërë përmirësimin e dispozitivit të aktakuzës, në rreshtin e katërt ku është shënuar “me datë 02.06.2022” e ku duhet të jetë “me datë 01.06.2022”.

Në fjalën hyrëse, prokurori i shtetit ka deklaruar se pas zhvillimit të hetimeve në çështjen penale kundër të pandehurit S.U. për veprën penale si në aktakuzë, prokuroria ka ngritur aktakuzë duke u bazuar në prova dhe deklarata të të dëmtuarve gjegjësisht dëshmitarëve të propozuar në aktakuzë, për të cilët është bërë hetimi i veçantë me datë 07.06.2022, duke i propozuar gjykatës që të vazhdoj shqyrtimin gjyqësor, e pas administrimit të provave do të vërtetohet se i pandehuri S.U. ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet. Ndërsa, në fjalën përfundimtare prokurori i shtetit ka deklaruar se pas administrimit të provave është vërtetuar gjendja faktike si në aktakuzë, duke shtuar se kjo gjendje faktike është vërtetuar nga deklaratat e të dëmtuarve- dëshmitarëve të dhëna në polici dhe në gjykatë para trupit gjykues në mundësinë hetuese të veçantë, të cilët në deklarata e tyre kanë theksuar se udhëtimi i tyre ka qenë i organizuar qysh nga Turqia dhe i

planifikuar në relacionin Turqi, Greqi, Shqipëri, Kosovë me destinim në shtetet e Evropës perëndimore. Pastaj, prokurori i shtetit ka thënë se të gjithë të dëmtuarit-dëshmitarët kanë deklaruar se që nga nisja e tyre nga Turqia kanë paguar shuma të të hollave prej rreth 2600 euro për rrugëtimin e lart cekur, ndërsa në shtetet tjera nuk kanë paguar asgjë, duke shtuar se kufirin për në Kosovë e kanë kaluar në këmbë, në kufi sipas marrëveshjes i kanë pritur disa persona të cilët fillimisht i kanë dërguar në një shtëpi me podrum ku iu kanë thënë që të qëndrojnë aty deri sa të errësohet që të mos i diktoj dikush, e pastaj në atë shtëpi disa persona kanë shkuar me makina në mënyrë të organizuar, i kanë marrë dhe i kanë dërguar të autobusi me të cilin pasi kanë hipur kanë udhëtuar rreth një orë, pastaj shoferi i autobusit iu ka thënë që të shkojnë në autobusin e dytë në të cilin kanë hipur, por siç kanë thënë, nuk kanë kontaktuar me shoferin, i cili nuk iu ka kërkuar as para e as bileta, dhe se arsyet pse nuk kanë paguar asgjë për këtë udhëtim kanë theksuar se ka qenë për shkak se siç e kanë quajtur kontrabandisti me të cilin ishin marrë vesh në Turqi dhe ia kishin paguar të hollat në shumën si më lart, përkatësisht i njëjti iu ka thënë se me këtë shumë i kanë mbuluar të gjitha shpenzimet. Po ashtu, prokurori i shtetit ka theksuar se mbrojtjen e të pandehurit në shqyrtim gjyqësor, se nuk i ka pritur dhe nuk e ka ditur paraprakisht për të dëmtuarit se do të udhëtonin me autobusin e tij dhe se ai - i pandehuri nuk ka qenë pjesë e organizmit për bartjen e këtyre udhëtareve drejt M., gjykata duhet ta refuzoj si të pa bazuar dhe në drejtim të ikjes nga përgjegjësia penale sepse nga deklarata e të gjithë dëshmitarëve të dëmtuarve që kanë dhënë para trupit gjykues, vërtetohet se në rrugëtimin e tyre gjithçka ka qenë e organizuar mirë rreth kontrabandimit të tyre siç ka theksuar më lart, duke i propozuar gjykatës që të akuzuarin ta shpallë fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit, ndërsa gjatë matjes së dënimit t'i ketë parasysh të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese, dhe se mbetet pranë propozimit për konfiskimin e sendeve të sekuestruara.

Mbrojtësi i të akuzuarit në fjalën hyrëse ka deklaruar se me provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet kryerja e veprës penale nga i pandehuri, për faktin se autobusi në fjalë është aset i “N.T.P Q...” nga M., i cili ofron dhe ushtron veprimtarinë e shërbimeve të transportit të udhëtarëve në vijat Mitrovicë- Prishtinë dhe anasjelltas sipas vendimit të lëshuar nga autoritetet kompetente, duke theksuar se autobusi ka qenë i parkuar në peronin e dedikuar për Mitrovicë, ka pasur tabelën Prishtinë-Mitrovicë, nuk është në kompetencën e të pandehurit të bëjë selektimin e udhëtarëve, në autobus kanë hyrë udhëtarë të cilët kanë pasur ndërmend që të udhëtojnë për Mitrovicë, në stacionin e autobusëve në Prishtinë ekziston vend i posaçëm ku qëndrojnë policia e Kosovës të cilët në rast dyshimi janë të autorizuar ta bëjnë identifikimin e udhëtarëve. Po ashtu, mbrojtësi ka thënë se janë dëgjuar dëshmitarët e propozuar në aktakuzë të cilët e vërtetojnë se vetëm pas hyrjes së tyre diku 5-10 minuta ka hyrë vozitësi i cili është nisur në drejtim të Mitrovicës, andaj konsideron se në mungesë të provave i akuzuari duhet liruar nga akuza. Ndërsa, në fjalën përfundimtare të përgatitur me shkrim mbrojtësi ka thënë se akuza e ngritur nga prokuroria është paushalle dhe e pa argumentuar me prova të cilat gjenden në shkresat e çështjes, me arsyetim se i pandehuri ka deklaruar se në relacionin Mitrovicë - Prishtinë dhe anasjelltas ka linjën e rregullt të transportit të udhëtarëve, duke shtuar se ditën kritike është nisur nga Mitrovica për në Prishtinë rreth orës 18:15 por për shkak të një defekti në autobus ka arritur me 15 minuta vonesë e pastaj në Stacionin e Autobusëve në Prishtinë është marrë me rregullimin e defektit të autobusit, ndërsa rreth orës 21:10 ka shkuar për të hipur në autobus me qëllim kthimi për Mitrovicë, dyert e autobusit kanë qenë të hapura dhe aty një turmë e njerëzve e kanë pyetur për drejtimin e udhëtimit duke i thënë “ Mitrovicë, Mitrovicë”, e meqë tani i akuzuari nuk e ka ditur gjuhën e tyre, atyre iu ka thënë “Yes Yes” dhe ai kur ka hyrë në autobus i ka parë rreth 30 persona të ulur, ndërsa rreth 15-20 persona kanë hyrë pas tij, e të cilët e kanë pyetur për çmimin e biletës në relacionin Prishtinë- Mitrovicë e ai i ka njoftuar se çmimi i biletës është dy euro e pas kësaj janë nisur ndërsa përmes telefonit ka ftuar vëllain e tij që të dal në hyrje të Mitrovicës që ta sjellë arkën fiskale për ta bërë pagesën e biletave

të udhëtarëve. Po ashtu, mbrojtësi ka thënë se qëndron fakti se personat që kanë hyrë në autobus kanë qenë të huaj pasi është vërejtur nga gjuha dhe nga pamja e tyre, por udhëtimi i tyre në relacionin e rregullt sipas linjës së udhëtimit për Mitrovicë nuk do të thotë se ai – tani i akuzuari është marrë me kontrabandimin e tyre, pasi ai nuk ka mundur t'ua mohoj udhëtimin me autobus i cili është i dedikuar për udhëtarë, pastaj nuk ka pasur kurrfarë autorizimi të bëj identifikimin e tyre, me çfarë qëllimi kanë dashur të udhëtojnë për në Mitrovicë, duke shtuar se është e palogjikshme të theksohet se është marrë me kontrabandimin e tyre. Gjithashtu, mbrojtësi ka thënë se dëshmitarët kanë treguar për mënyrën e udhëtimit deri në momentin e hyrjes dhe qëndrimit në Kosovë, duke shtuar se dëshmitari A.H. ka thënë se kur kanë zbritur nga autobusi me të cilin kanë ardhur në stacionin e autobusëve në Prishtinë, vozitësi i atij autobusi- i pa identifikuar nga organet e ndjekjes, iu ka thënë që të hipin në autobusin e tani të pandehurit i cili ka qenë i parkuar, ndërsa për të pandehurin ka theksuar se e ka parë vetëm gjatë vozitjes së autobusit, dhe se nuk kanë bërë pagesë. Po ashtu, mbrojtësi ka thënë se të njëjtat rrethana i vërteton edhe dëshmitari B.J., i cili në mënyrë identike ka shpjeguar ngjarjen, e i cili ka thënë se kur kanë hipur në autobusin për në Mitrovicë aty nuk ka qenë vozitësi- tani i pandehuri S., duke shtuar se edhe nga dëshmitë e dëshmitarëve M.S., M.K., M.A., A.M., vërtetohen të njëjtat rrethana, ashtu siç kanë deklaruar dëshmitarët A.H. dhe B.J. dhe se i mbrojturi i tij nuk ka pasur njohuri për mënyrën e hyrjes së këtyre udhëtarëve në Republikën e Kosovës, nëse hyrja e tyre ka qenë e ligjshme apo e paligjshme ngase nuk ka qenë në kompetencën e tij të bëj një verifikim të tillë, duke shtuar se tani i akuzuari ka qenë vetëm drejtues i autobusit dhe se nuk ka pasur ndonjë marrëveshje paraprake për transportimin- kontrabandimin e tani të dëmtuarve. Mbrojtësi ka theksuar se edhe po të kishte dëshiruar, tani i pandehuri nuk do të mund t'ia mohonte udhëtimin askujt, duke shtuar se të mbrojturit të tij i janë sekuestruar mjete financiare dhe telefoni Samsung, gjëra të cilat nuk kanë të bëjnë më veprën penale, pasi që mjetet financiare i ka pasur në disponim gjatë transportit ditor të udhëtarëve, duke theksuar se i mbrojturi i tij nuk ka qenë personi i cili është dashur ta vërtetoj mënyrën e hyrjes së të dëmtuarve në Republikën e Kosovës. Në fund të fjalës së tij përfundimtare, mbrojtësi i ka propozuar gjykatës që të mbrojturin e tij, konform nenit 363, par.1, pika 1.3 të KPP ta liroj nga akuza.

I akuzuari S.U., në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se nuk ka çfarë të shtoj, përveç se e përkrah fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor, me pajtimin e palëve në procedurë, janë lexuar deklaratat e të dëmtuarve – dëshmitarëve: M.S., M.K., M.A., A.M., A.Sh.H. dhe B.J., të dhëna gjatë hetimit të veçantë me datë 07.06.2022 në këtë gjykatë, janë administruar provat materiale të propozuara nga prokuroria dhe i akuzuari ka dhënë mbrojtjen e tij, e të paraqitura si në vijim:

Dëshmia e të dëmtuarit - dëshmitarit M.S., i cili pasi është udhëzuar me të drejtat dhe detyrimet e tij, nën betim, në pyetje të prokurorit të shtetit ka deklaruar se ka dhënë dëshmi në polici me datë 02.06.2022 dhe mbetet pranë saj, duke theksuar se janë nisur nga Siria, për në Turqi pastaj kanë vazhduar për në Greqi, Shqipëri dhe në fund kanë arritur në Kosovë, por se nuk ka informacion për organizim e udhëtimit të tyre, përveç se kanë udhëtuar me autobus. Po ashtu, i dëmtuari - dëshmitari M.S. ka thënë se në Turqi në një zyre kanë paguar një shumë të hollave, duke shtuar se nuk e di kush e ka marrë përsipër udhëtimin e tyre, dhe se ai vetëm në Greqi në qytetin L. ka dhënë të holla në shumë prej 1100 euro, ndërsa në kufi para se të futen në Kosovë nëpër mal ia kanë marrë me forcë 30 euro, pastaj në Kosovë kanë mbërri natën pa e ditur se nga po shkojnë, duke ecur në këmbë, pastaj personat që i kanë marrë në kufi fillimisht i kanë dërguar te një shtëpi, pastaj deri te autobusi, dhe të njëjtit nuk kanë biseduar me shoferin e autobusit. Pastaj, i dëmtuari - dëshmitari M.S. ka thënë se kanë qenë rreth 50 persona, në mesin e tyre ka pasur familje Kurde, nga Bangladeshi dhe nga Siria, duke theksuar se kur kanë shkuar

te autobusi, ka qenë vetëm shoferi në të dhe kanë qenë dy autobusë në të cilët kanë hipur, e të cilat i kanë dërguar në një vend tjetër - parking të autobusëve e pastaj ka ardhur një autobus tjetër dhe i ka marrë, duke theksuar se shoferi i këtij autobusi ka qenë tani i pandehuri i pranishëm në sallë, dhe se shoferi i parë iu kishte thënë “shkoni te ky autobus, hipni”, duke theksuar se personi në sallë – tani i pandehuri nuk ka qenë në autobus, por pas 5-10 minuta ka ardhur, nuk iu ka kërkuar askush bileta e as të holla, janë nisur por nuk e di sa kanë udhëtuar me këtë autobus pasi ka fjetur dhe është befasuar kur e ka parë policinë në autobus. Po ashtu, i dëmtuari - dëshmitari M.S. ka thënë se destinacioni i tij ka qenë për Gjermani ose Holandë, me arsyetim se është i rrezikuar në Siri.

Në pyetjet e mbrojtësit të pandehurit S.U., av. Nuhi Krasniqi, dëshmitari M.S. është përgjigjur se në vendin ku kanë hipur në autobus ka qenë stacion i autobusëve, ka pasur edhe autobusë tjerë por nuk e di cili qytet ka qenë dhe se nuk kishte informata se për ku ka qenë destinacioni i autobusit pasi gjuhën nuk e ka njohur dhe askush prej tyre nuk ka kontaktuar me shoferin.

Në pyetjet e anëtares së trupit gjykues, dëshmitari M.S. ka thënë se destinacioni i tyre ka qenë Serbia por nuk e kanë ditur se kush do t'i dërgoj deri atje, pasi në fillim atyre u kishin thënë se nëpër qytet do të lëvizin me vetura, por i kanë futur në autobus, ndërsa kufirin do ta kalonin nëpër rrugë malore.

Në pyetje të anëtarit të trupit gjykues dëshmitari M.S. është përgjigjur se pagesa prej 1100 euro ka përfshirë udhëtimin prej Greqisë deri në Serbi, pa përfshirë ushqimin, dhe se shoferi i autobusit të parë iu kishte thënë të gjithëve “shkoni te ky autobus duke na drejtuar me gisht”, në të cilin nuk kanë paguar asgjë, por mendon se autobusi i parë ka qenë në zingjirin e rrjetit që i ka përcjellë nga Greqia deri në Kosovë.

Në pyetje të kryetarit të trupit gjykues dëshmitari M.S. ka thënë se në total ka paguar 2600 euro në Turqi, ndërsa sipas marrëveshjes një pjesë të atyre mjeteve nga Turqia janë dërguar në Greqi, derisa dokumentet e udhëtimit i kanë mbetur në Siri. Në fund të dëshmisë së tij, i dëmtuari - dëshmitari M.S. ka thënë se nuk kërkon kompensim material e as nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale pasi që nuk e di se tani i pandehuri është pjesë e organizimit të tyre për udhëtimin e tyre në Kosovë.

Dëshmia e të dëmtuarit - dëshmitarit M.K., i cili pasi është udhëzuar me të drejtat dhe detyrimet e tij, nën betim, në pyetje të prokurorit të shtetit ka deklaruar se mbetet pranë deklaratës që ka dhënë në polici me datë 02.06.2022, duke shtuar se ka paguar një herë 1500 dhe një herë 1100 euro në zyrën në Turqi, dhe se kur kanë mbërrirë në Kosovë, pastaj një person i ka dërguar te një shtëpi afër kufirit dhe nga Shqipëria kanë hyrë në Kosovë nëpër rrugë malore. Pastaj, i dëmtuari - dëshmitari M.K. ka thënë se kur i ka ndaluar policia ata kanë qenë rreth 50 veta dhe e kanë ditur se janë duke udhëtuar drejt Serbisë, duke shtuar se kanë shkuar me makinë deri te autobusi i parë me të cilin kanë udhëtuar rreth një orë e gjysmë, ndërsa nga autobusi i parë kanë kaluar në një autobus tjetër, me të cilin kanë udhëtuar gjysmë ore deri sa i ka ndaluar policia, duke theksuar se në këtë autobus nuk kanë paguar bileta dhe se shoferi i autobusit të dytë nuk i ka pyetur se ku po shkojnë, e as nuk e njeh të njëjtin pasi ka qenë i ulur në fund të autobusit.

Në pyetje të mbrojtësit të pandehurit, i dëmtuari - dëshmitari M.K. është përgjigjur se nuk e njeh shtëpinë në kufirin Kosovë - Shqipëri ku kanë qëndruar, me arsyetim se kur kanë hyrë dhe kur kanë dalë ka qenë errësirë dhe se nuk kanë njohuri e as që kanë pasur kontakt me pronarin e asaj shtëpie, duke theksuar se nuk e di çfarë kompanie ka qenë dhe nuk e njeh vendin, por e di se ka pasur autobusë në vendin ku është ndaluar autobusi i parë, ndërsa askush nga ata – tani të dëmtuarit në autobus nuk ka shkuar për te pyetur për çmimin e biletës dhe nuk e njohin personin që i ka drejtuar për në autobusin e dytë.

I pandehuri S.U. ka thënë se nuk ka pyetje për të dëmtuarin - dëshmitarin M.K. por ka vërejtje me arsyetim se dy persona kanë pritur te dera e autobusit dhe e kanë pyetur “how much” gjë që sipas tij nënkupton se e kanë pyetur për çmimin e biletës.

Në fund të dëshmisë së tij, i dëmtuari - dëshmitari M.K. ka thënë se dokumentet e udhëtimit i ka te disa familjarë në Turqi, dhe se nuk kërkon kompensim dëmi e as nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale.

Dëshmia e të dëmtuarit - dëshmitarit M.A., i cili pasi është udhëzuar me të drejtat dhe detyrimet e tij, nën betim, në pyetje të prokurorit të shtetit ka deklaruar se mbetet pranë deklaratës së dhënë në polici me datë 02.06.2022, duke shtuar se janë nisur prej Turqisë në Greqi, pastaj Shqipëri dhe Kosovë, me qëllim për të shkuar në Holandë, e për të cilin udhëtim ka paguar 1500 euro në Turqi, për të udhëtuar deri në Serbi, dhe se ai me disa persona kanë ecur me GPS nga Turqia në Greqi përmes malit, e po ashtu ka paguar edhe 1100 euro shtesë në Turqi. Pastaj, i dëmtuari – dëshmitari si më lart ka thënë se në Kosovë janë futur përmes rrugëve malore dhe janë vendosur në një fshat aty afër në një shtëpi që ka qenë me podrum, aty kanë qëndruar deri sa është errësuar, e pastaj disa makina i kanë marrë dhe i kanë dërguar deri te autobusi, me të cilin kanë udhëtuar rreth një orë e pastaj janë ndalur te një vend i autobusëve, ku ka dalë shoferi i autobusit të parë dhe iu ka thënë “shkoni në autobusin tjetër”, në të cilin kur kanë hipur nuk iu është kërkuar që të paguajnë biletën dhe nuk kanë kontaktuar me shoferin e autobusit, duke theksuar se ai - i dëmtuari – dëshmitari si më lart ka hipur në autobus nga dera e prapme dhe nuk e ka parë se a ka qenë shoferi aty, si dhe nuk e di sa ka zgjatur udhëtimi pasi që ka fjetur herë pas here, e pastaj i ka ndalur policia. Në fund të dëshmisë së tij, i dëmtuari - dëshmitari M.A. ka thënë se nuk kërkon kompensim dëmi e as nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale, pasi që nuk di asgjë për personin që i ka bartur – tani të akuzuarin.

I pandehuri S.U. ka thënë se nuk ka pyetje për dëshmitarin M.A. por ka vërejtje se për punë të pagesës është dashur që vëllai i tij rrugës të hipë në autobus ta merr arkën fiskale dhe ta bëj pagesën.

Dëshmia e të dëmtuarit - dëshmitarit A.M., i cili pasi është udhëzuar me të drejtat dhe detyrimet e tij, nën betim, në pyetje të prokurorit të shtetit ka deklaruar se mbetet pranë deklaratës së dhënë në polici me datë 02.06.2022, duke përshkruar ngjarjen se fillimisht kishin ecur tri orë, pastaj i kishin futur në podrumin e një shtëpie dhe kur ishte errësuar i kishin marrë me makina që të mos i shihnin banorët për rreth, ndërsa pas udhëtimit me makina i kishin futur në një autobus me të cilin kishin udhëtuar rreth një orë e gjysmë, gjatë kësaj kohe kishte fjetur derisa i kishte parë udhëtarët e tjerë që po hipin në një autobus tjetër, në të cilin kishte hipur edhe vet. Pastaj, i dëmtuari – dëshmitari si më lart ka thënë se për këtë udhëtim vëllai i tij në Turqi ka paguar 2600 euro, pagesë kjo e cila ka vlejtur deri në Serbi, duke shtuar se në autobusin e dytë nuk iu është kërkuar pagesa për biletë, duke theksuar se nuk kërkon kompensim dëmi e as nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale, me arsyetim se nuk e njeh personin që i ka bartë – tani të akuzuarin.

Dëshmia e të dëmtuarit - dëshmitarit A.Sh.H., i cili pasi është udhëzuar me të drejtat dhe detyrimet e tij, nën betim, në pyetje të prokurorit të shtetit ka deklaruar se mbetet pranë dëshmisë së dhënë në polici me datë 02.06.2022, duke shtuar se ishin nisur nga Turqia, pasi motra e tij kishte paguar shumë prej 2600 euro për udhëtimin deri në Serbi, duke përshkruar ngjarjen kur kishin dalë prej autobusit të parë, shoferi iu kishte thënë “kaloni në autobusin e dytë”, edhe pse autobusi i parë nuk ishte prishur por ata nuk e dinin arsyen pse iu kishin thënë për t’i ndërruar autobusët dhe se çka iu kishin thënë ata të vepronin, tani të dëmtuarit kishin vepruar, përkatësisht atyre u kishin thënë të mos flisnin, mos t’i përdornin dhe t’i fikin telefonat gjatë rrugës kur kanë hyrë nga Shqipëria në Kosovë, duke i kërcënuar se nëse e zinin dikë duke folur me telefon do ta rrahin. Në pyetjet e mbrojtësit të tani akuzuarit S.U., i dëmtuari - dëshmitari A.Sh.H. është përgjigjur se personat që i kishin urdhëruar si më lart, kanë qenë persona të ndryshëm, të cilët me ta kishin komunikuar me një arabishte të keqe, duke shtuar se kishin qenë rreth 50 persona,

se ishte natë dhe nuk kishin mundësi që t'i shihnin dhe se për herë të parë ishin takuar në kufirin Shqipëri - Kosovë. Pastaj, i dëmtuari - dëshmitari si më lart ka thënë se të pandehurin – tani të akuzuarin në sallë e kishte parë vetëm në autobus sepse ai e kishte vozitur autobusin, derisa gjatë rrugës kishin takuar njerëz me kombësi të ndryshme, ndërsa në Kosovë kishin hyrë së bashku 50-60 persona, e të gjithë së bashku kishin qenë edhe në autobusin e parë edhe në të dytin, ku kishte edhe gra, me të cilët kishin udhëtuar së bashku prej kufirit.

Në fund të dëshmisë së tij, i dëmtuari – dëshmitari A.Sh.H., ka thënë se në autobusin e dytë nuk kishin paguar asgjë dhe nuk iu ishte kërkuar që të paguajnë, duke shtuar se nuk kërkon kompensim dëmi e as nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale.

Dëshmia e të dëmtuarit - dëshmitarit B.J., i cili pasi është udhëzuar me të drejtat dhe detyrimet e tij, nën betim, në pyetje të prokurorit të shtetit ka deklaruar se mbetet pranë deklaratës së dhënë në polici me datë 02.06.2022, duke shtuar se janë nisur nga Turqia me qëllim që të shkojnë në Gjermani, pasi në Zyrën e Sigurimeve në Turqi, siç thotë i dëmtuari, vëllai i tij ka paguar, pastaj prej Turqisë kanë ecur në këmbë 15 ditë deri në Selanik, ndërsa prej Greqisë në Shqipëri kanë udhëtuar me autobus, derisa në Kosovë kanë hyrë në këmbë përmes rrugëve malore, duke theksuar se nuk e di kush i ka pritur në Kosovë pasi ka qenë terr - errësirë, dhe se nuk ka pasur informacion se kush i pret në Kosovë, si dhe nuk ka biseduar me ndonjë kontrabandist, e pastaj kanë ardhur me autobus në parking të autobusëve, kanë hipur në autobusin tjetër në të cilin nuk ka qenë shoferi, por se shoferi i autobusit të parë iu kishte thënë “hipni në këtë autobus”, në të cilin nuk kanë paguar biletë. Në pyetje të mbrojtësit të pandehurit S.U., i dëmtuari - dëshmitari B.J. është përgjigjur se nuk kanë qenë personat e njëjtë që i kanë përcjellë prej Shqipërisë, përkatësisht në autobusin e parë kanë udhëtuar ndoshta dy orë e gjysmë, nuk ka mundur të vërej ndonjë mbishkrim në autobus, por se shoferi i autobusit të parë iu ka thënë që të hipin në autobusin e dytë, duke theksuar se iu kanë thënë se kufirin Kosovë - Serbi do ta kalojnë këmbë dhe se shoferi i autobusit ka qenë personi në sallë, përkatësisht i dëmtuari si më lart i drejtohet tani të akuzuarit S.U. Po ashtu, i dëmtuari - dëshmitari B.J. ka theksuar se nuk e di nëse udhëtimi me autobus ka qenë i rastit apo i organizuar, por se shoferi i autobusit të parë iu ka thënë se ka prishje në autobusin e parë dhe duhet të dalin në të dytin, në të cilin nuk i kujtohet të ketë pasur banorë vendas sepse ka qenë errësirë, duke shtuar se nuk kërkon kompensim dëmi dhe nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale.

Nga provat materiale si në vijim, përkatësisht:

- Vërtetimi mbi marrjen e përkohshme të sendeve i datës 02.06.2022, sipas të cilit autobusi “Mercedes” me targa ..., çelësi i këtij autobusi, i liruar dhe kthyer të pandehurit me aktvendimin e Gjykatës së Apelit PN.nr.855/2022 të datës 19.08.2022, një Telefon Samsung A 32 me numër IMEI ..., 800 € të holla të gatshme, si dhe librezën e qarkullimit të autobusit nr. CRA ..., pronë e të pandehurit S.U., si sende të përdorura për kryerjen e veprës penale dhe si sende të përfituara nga kryerja e veprës penale,

- Raporti i Agjencisë së Kosovës për Forenzikë - AKF për ekzaminimin e telefonit Samsung me numër IMEI ..., sipas të cilit rezultoi se me datë 01.06.2022 në ora 20:43 të pandehurin e ka thirr në telefon një person me emrin A. dhe me të kanë biseduar dy minuta.

- Foto dokumentacioni nga vendi i ngjarjes, nga të cilat vërtetohet se në ditën kritike pas ndalimit të pandehurit S.U. i cili ishte duke vozitur autobusin e firmës “Q...” të tipit Mercedes, me targa ..., policia në autobus ka hasur 57 shtetas të huaj nga Siria, Egjipti, Iraku, Palestina, Bangladeshi etj., nën dyshimin për kontrabandim të migrantëve nga i pandehuri.

Pas paraqitjes së provave materiale nga prokurori i shtetit, mbrojtësi i të akuzuarit ka bërë vërejtje me arsyetim se me dëshmitë e dëshmitarëve pa mëdyshje vërtetohet se i pandehuri ditën kritike nuk ka bërë asnjë pagesë të biletave të udhëtarëve për faktin se me rastin e nisjes nga stacioni i autobusëve ka ftuar vëllain e tij që ta sjellë arkën fiskale për pagesën e biletave, e këtë e kanë deklaruar edhe dëshmitarët, duke shtuar se paratë prej 1300 euro kanë qenë të fituara gjatë ditëve të punës duke pasur parasysh se nuk janë para të fituara me kryerjen e veprës penale, dhe duke i propozuar gjykatës që të gjitha sendet e sekuestruara t'i kthehen të pandehurit.

Pasi që kryetari i trupit gjykues, në bazë të nenit 344 të KPP e ka njoftuar të akuzuarin se ka të drejtë të mos deklarohet lidhur me çështjen, e nëse zgjedh të deklarohet marrja e tij në pyetje do të zbatohet në pajtim me paragrafët 2 dhe 4 të këtij neni, i akuzuari ka thënë se do ta shfrytëzoi të drejtën e tij për të deklaruar dhe meqenëse mbrojtësi i tij ka thënë se nuk ka pyetje për të akuzuarin, në pyetje nga prokurori i shtetit, i akuzuari është përgjigjur se si shofer i autobusit punon shumë rrallë, përkatësisht nga viti 2005 punon te “Q...” me pronar babain e tij R.U., duke shtuar se më shumë ka punuar me pagë si konduktor dhe menaxher. Pastaj, i akuzuari ka thënë se te “Q...” punojnë 5-7 punëtorë, me linjë të rregullt Mitrovicë - Prishtinë dhe anasjelltas, tetë herë në ditë dhe se ditën për të cilën po akuzohet ka qenë duke e drejtuar autobusin në relacionin Prishtinë – Mitrovicë, kur policia e ka ndaluar në fshatin M., Komuna Obiliq, me orar nisje nga Prishtina në ora 20:00, por pasi kishte pasur problem - defekt teknik në autobus me frenin e dorës, ai është ndaluar nga policia rreth orës 21:10 në fshatin M. Pastaj, i akuzuari ka thënë se në Prishtinë autobusi ka qenë në parking e jo në peronin 4 të paraparë për Mitrovicë sepse i kishte kaluar koha e orarit për udhëtarë pasi është vonuar deri sa e ka rregulluar frenin e dorës së autobusit të cilin e ka rregulluar për 20-25 minuta dhe për Mitrovicë është nisur rreth orës 20:45 ku i ka vërejtur disa pasagjerë te autobusi, disa prej tyre kishin hyrë brenda pasi e kanë parë tabelën Prishtinë – Mitrovicë dhe pasi që nuk ka pasur nisje tjetër në atë kohë, ka vendosur për bartjen e atyre pasagjerëve deri në Mitrovicë pasi e ka pasur rrugën dhe relacionin për atje, si dhe paraprakisht dy nga udhëtarët kanë thënë fjalën “Mitrovicë, Mitrovicë” e të cilët nuk e kanë ditur gjuhën shqipe, ndërsa ai iu kishte thënë “Yes, Yes”, pastaj kanë hyrë në autobus dhe janë nisur dhe dikush nga udhëtarët e ka pyetur në gjuhën angleze “how much” - sa kushton, ai iu ka thënë në gjuhën angleze 1 euro e 50 cent për person, në çmimin e tregut, por udhëtarët në autobus nuk kanë paguar biletë pasi nuk e ka pasur arkën fiskale, për të cilën e ka thirrur vëllain e tij A. që të dalë në rrugë në hyrje të Mitrovicës për t'i kryer pagesat e biletave sepse atë ditë e ka pasur arkën fiskale në autobusin tjetër i cili ka pasur nisjen në ora 19:30 në të cilin konduktori i kryen biletat dhe e pret atë – tani të akuzuarin me autobusin e orarit 20:00, dhe se në atë kohë kanë përdoruar dy arka fiskale. Po ashtu, i akuzuari ka thënë se atë ditë para këtij udhëtimit për në Mitrovicë nuk ka pasur udhëtim tjetër sepse ka bartur nxënësit e shkollës së fshatit Kqiq për shëtitje në parkun e Gërmisë. Po ashtu, i akuzuari ka theksuar se nuk ka të drejtë t'i pyes udhëtarët kush janë dhe nga vijnë, përkatësisht t'i legjitimoj, përveç se tu jap biletat dhe ta ndalë autobusin në stacionin ku ata duan të zbresin, duke shtuar se nuk e di nëse në autobus ka pasur edhe udhëtarë shtetas të Kosovës dhe se nuk i ka pritur e as nuk e ka ditur paraprakisht se do të vijnë për të udhëtuar me të udhëtarë të cilët më vonë ka dalë se janë shtetas Aziatik, si dhe nuk ka qenë pjesë e organizuar për bartjen e këtyre udhëtarëve drejt Mitrovicës.

Pas vlerësimit të dëshmive të dëmtuarve - dëshmitarëve, administrimit të provave materiale dhe mbrojtjes së të akuzuarit, aktgjykimi si më lart është bazuar vetëm në faktet dhe provat e proceduara gjatë shqyrtimit gjyqësor, siç parasheh dispozita e nenit 360 të KPP, e për të cilat do të jepet vlerësimi si në vijim:

Nga dëshmia e të dëmtuarit - dëshmitarit M.S., është vërtetuar se ai dhe bashkudhëtarët e tij janë nisur nga Siria, për në Turqi pastaj kanë vazhduar për në Greqi, Shqipëri dhe në fund

kanë arritur në Kosovë me qëllim që të shkojnë në Gjermani ose Holandë, pasi ka paguar 2600 euro në Turqi, pastaj në Greqi në qytetin L. kishte paguar 1100 euro dhe në kufi para se të futet në Kosovë nëpër mal ia kanë marrë me forcë 30 euro. Po ashtu, sipas të dëmtuarit – dëshmitarit si më lart është vërtetuar se disa persona i kanë marrë në kufi, i kanë dërguar te një shtëpi, pastaj deri te autobusi, me shoferin e të cilit nuk kanë biseduar por kanë udhëtuar deri te një parking i autobusëve në një autobus tjetër, në të cilin nuk iu kanë kërkuar bileta e as të holla e as që ka kontaktuar me shoferin. Sipas mendimit të dëmtuarit - dëshmitarit M.S., autobusi i parë ka qenë në zingjirin e rrjetit që i ka përcjellë nga Greqia deri në Kosovë, por nuk ka kërkuar kompensim dëmi e as nuk i është bashkëngjitur ndjekjes penale ndaj të akuzuarit, me arsyetim se nuk e di nëse tani i akuzuari është pjesë e organizimit të tyre për udhëtimin e tyre në Kosovë.

Nga dëshmia e të dëmtuarit - dëshmitarit M.K., është vërtetuar se i njëjti ka paguar një herë 1500 euro dhe një herë 1100 euro në një zyrë në Turqi, pastaj rreth 50 veta kanë udhëtuar dhe kanë mbërrirë në Kosovë, pasi një person i kishte dërguar në një shtëpi afër kufirit dhe nga Shqipëria në Kosovë kanë hyrë nëpër rrugë malore dhe se nga aty janë nisur drejt Serbisë, përkatësisht deri te autobusi i parë kanë shkuar me makina, kanë hipur në autobusin me të cilin kanë udhëtuar rreth një orë e gjysmë dhe nga ky autobus kanë kaluar në një autobus tjetër, me të cilin kanë udhëtuar gjysmë ore deri sa i ka ndaluar policia. Po ashtu, nga dëshmia e këtij të dëmtuari – dëshmitari është vërtetuar se në këtë autobus nuk kanë paguar bileta dhe se shoferi i tij nuk i ka pyetur se ku po shkojnë e as nuk e njeh të njëjtin – tani të akuzuarin, pasi ka qenë i ulur në fund të autobusit.

Nga dëshmia e të dëmtuarit - dëshmitarit M.A., është vërtetuar se ai së bashku me më shumë se 50 veta janë nisur prej Turqisë në Greqi, pastaj Shqipëri dhe Kosovë, me qëllim për të shkuar në Holandë, e për të cilin udhëtim ka paguar veç e veç 1500 euro dhe 1100 euro në Turqi, për të udhëtuar deri në Serbi, së bashku me disa persona tjerë me të cilët kanë ecur me GPS nga Turqia në Greqi përmes malit. Po ashtu, nga dëshmia e këtij të dëmtuari – dëshmitari është vërtetuar se tani të dëmtuarit në Kosovë janë futur përmes rrugëve malore dhe janë vendosur në një fshat nga ku i kanë marrë me disa makina dhe i kanë dërguar deri te autobusi, me të cilin kanë udhëtuar rreth një orë deri te një vend i autobusëve, me ç rast shoferi i autobusit të parë iu ka thënë “shkoni në autobusin tjetër”, në të cilin kanë hipur por nuk iu është kërkuar që të paguajnë biletë dhe nuk ka kontaktuar me shoferin e autobusit e as që e ka parë atë.

Nga dëshmia e të dëmtuarit - dëshmitarit A.M., është vërtetuar se për udhëtimin e tij nga Turqia deri në Serbi, vëllai i tij në Turqi ka paguar 2600 euro, pastaj për ta kaluar kufirin Shqipëri – Kosovë kishin ecur tri orë, ndërsa personat që i kanë shoqëruar i kishin futur në podrumin e një shtëpie e kur ishte errësuar i kishin marrë me makina që të mos i shihnin banorët për rreth dhe i kishin futur në një autobus me të cilin kishin udhëtuar rreth një orë e gjysmë, ndërsa gjatë këtij udhëtimi ai kishte fjetur derisa i kishte parë udhëtarët e tjerë që po hipin në një autobus tjetër, në të cilin kishte hipur edhe vet.

Nga dëshmia e të dëmtuarit - dëshmitarit A.Sh.H., është vërtetuar se ai ishte nisur nga Turqia për të udhëtuar deri në Serbi, pasi motra e tij kishte paguar shumë prej 2600 euro dhe gjatë udhëtimit në Kosovë me rreth 50 persona, kur kishin dalë nga autobusi i parë, shoferi i këtij autobusi me një arabishte të keqe iu kishte thënë “kaloni në autobusin e dytë”, pa i arsyetuar për këtë veprim, e ata - tani të dëmtuarit ashtu edhe kishin vepruar, ndërsa tani të akuzuarin në sallë e kishte parë vetëm në autobus pasi ai e kishte drejtuar autobusin.

Nga dëshmia e të dëmtuarit - dëshmitarit B.J., është vërtetuar se ai nuk ka biseduar me ndonjë kontrabandist, por së bashku me udhëtarët tjerë janë nisur nga Turqia me qëllim që të

shkojnë në Gjermani, pasi në Zyrën e Sigurimeve në Turqi, vëllai i tij kishte paguar për këtë udhëtim, pastaj prej Turqisë kanë ecur në këmbë 15 ditë deri në Selanik, kanë kaluar në Shqipëri ku kanë udhëtuar me autobus, ndërsa në Kosovë kanë hyrë në këmbë përmes rrugëve malore, derisa me autobus kanë shkuar deri në parking të autobusëve dhe kanë hipur në autobusin tjetër në të cilin nuk ka qenë shoferi, dhe se në të kishin hyrë pasi që shoferi i autobusit të parë iu kishte thënë “hipni në këtë autobus”, e në të cilin nuk kanë paguar biletë, dhe se nuk e di nëse udhëtimi me autobus ka qenë i rastit apo i organizuar.

Sipas thënieve të dëmtuarve – dëshmitarëve të paraqitura si më lart, nuk është vërtetuar se tani i akuzuari ka qenë pjesë e organizimit, përkatësisht kontrabandimit për udhëtimin e tyre në Kosovë, apo është i përfshirë në ndonjë mënyrë tjetër në këtë udhëtim, pasi nuk janë vërtetuar elementet kyçe të veprës penale përkatësisht përfitimi i drejtë për drejtë apo i tërthortë i dobisë financiare ose i ndonjë dobie pasurore, përkatësisht prokuroria në dispozitivin e aktakuzës ka përshtuar vetëm dispozitën e nenit 164, pa përcaktuar veprimet konkrete të tani të akuzuarit, se çfarë dobie pasurore ka përfituar, nga kush e ka përfituar këtë dobi pasurore, elementin e hyrjes së paligjshme të tani të dëmtuarve në territorin e Republikës së Kosovës, mos përmbushja e të cilave ka ndikuar që trupi gjykues të merr aktgjykim liruës pasi nuk ka arritur të provojë se i akuzuari ka kryer veprën penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Po ashtu, nga dëshmitë e të dëmtuarve, trupi gjykues nuk ka arritur të gjej ndonjë lidhshmëri apo komunikim të tani të akuzuarit me personat të cilët nga të dëmtuarit kanë marrë shuma të parave në Turqi siç i kanë përshtuar të dëmtuarit, e as me shoferin e autobusit të parë për të cilin të dëmtuarit kanë thënë se i ka drejtuar për në autobusin e dytë, të cilin e ka drejtuar tani i akuzuari.

Nga provat materiale është vërtetuar se tani të dëmtuarit, në Stacionin e Autobusëve në Prishtinë, në mbrëmjen e datës 02.06.2022 kanë hipur në autobusin “Mercedes” me targa ..., të cilin e ka drejtuar tani i akuzuari S.U. dhe me të kanë udhëtuar deri në fshatin Milloshevë, ku i ka ndaluar policia, ndërsa nga Telefon Samsung A 32 me numër IMEI ..., është vërtetuar vetëm fakti se i akuzuari atë natë ka komunikuar me vëllain e tij A., e sa i përket parave të sekuestruara të i akuzuarit, nuk është vërtetuar me asnjë provë se të njëjtat janë përfituar nga tani të dëmtuarit apo agjencia në Turqi ku tani të dëmtuarit kanë paguar për udhëtimin e tyre nga Turqia deri në Serbi, sepse vet të dëmtuarit kanë thënë se asnjëherë nuk kanë komunikuar me të akuzuarin S.U. e as nuk i kanë dhënë para atij.

Nga foto dokumentacioni nga vendi i ngjarjes, është vërtetuar se tani të dëmtuarit janë gjetur në autobusin e firmës “Q...” të tipit Mercedes, me targa ..., të cilin ka qenë duke e drejtuar tani i akuzuari S.U..

Trupi gjykues, ka vlerësuar edhe mbrojtjen e të akuzuarit, i cili i është shmangur pretendimeve në aktakuzë, duke theksuar se ka pasur një problem - defekt teknik në autobus me frenin e dorës, e pastaj është nisur rreth orës 20:45 ku i ka vërejtur disa pasagjerë të autobusi, disa prej tyre kishin hyrë brenda pasi e kanë parë tabelën Prishtinë – Mitrovicë dhe pasi që nuk ka pasur nisje tjetër në atë kohë, ka vendosur për bartjen e atyre pasagjerëve deri në Mitrovicë pasi e ka pasur rrugën dhe relacionin për atje, e për shkak se nuk e ka pasur arkën fiskale e ka thirrur vëllain e tij A. që të dal në rrugë në hyrje të Mitrovicës për t'i kryer pagesat e biletave, mbrojtje kjo e të akuzuarit e pa bazuar, marrë parasysh se i njëjti ka ofruar shërbime udhëtimi nga Prishtina në Mitrovicë dhe gjatë atij relacioni ka shumë stacione ku udhëtarët hyjnë dhe dalin pasi të kenë paguar biletën. Kjo mbrojtje e të akuzuarit është vlerësuar nga gjykata si shmangie nga përgjegjësia penale pasi të gjitha veprimet, përkatësisht: defekti në autobus, udhëtarët shtetas të huaj, qëndrimi i tij në parkingun e stacionit të autobusëve dhe mungesa e arkës fiskale

dobësojnë besueshmërinë e mbrojtjes së tij, por që me asnjë provë tjetër relevante nuk është vërtetuar e kundërta e mbrojtjes së tij.

Lidhur me pretendimet e prokurorit të shtetit të përshkruara në aktakuzë, se i akuzuari S.U. është marrë me kontrabandim të migrantëve, bazuar në dëshmitë dhe provat materiale të paraqitura si më lart, përkatësisht mungesa e fakteve për lidhjen në mes tani të akuzuarit dhe personave tjerë të cilët kanë organizuar udhëtimin dhe kontrabandimin e tani të dëmtuarve – migrantë, vë në mëdyshje ekzistimin e fakteve të rëndësishme për këtë çështje penale.

Trupi gjykues ka ardhur në përfundimin, se akuza e ngritur kundër S.U. nuk është e bazuar, pasi që prokuroria ka dështuar të paraqes prova të mjaftueshme dhe të besueshme për ta vërtetuar fajësinë e tij, përkatësisht aktakuza është bazuar vetëm në përshkrimin e përmbajtjen e deklaratave të dhëna nga tani të dëmtuarit, të cilët në asnjë mënyrë nuk kanë arritur ta inkriminojnë tani të akuzuarin U., përkatësisht nuk kanë folur me të, nuk kanë paguar para për udhëtimin dhe nuk është vërtetuar se i akuzuari ka pranuar para nga persona të tjerë – jo nga tani të dëmtuarit për kontrabandimin e tyre drejt Serbisë siç kanë thënë të dëmtuarit kur kanë deklaruar se udhëtimi i tyre ka qenë i paraparë nga Turqia deri në Serbi.

Bazuar në nenin 3 par. 2 të KPP, mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose zbatimin e dispozitave të ligjit penal, janë interpretuar në favor të akuzuarit dhe të drejtave të tij, sipas këtij kodi dhe sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe në pajtim me nenin 363 par. 1.3 të KPP, gjykata ka marrë aktgjykim lirues për të akuzuarin S.U., sepse nuk është provuar se i njëjti ka kryer veprën penale me të cilën është ngarkuar nga prokuroria.

Në këtë rast, gjykata është bazuar edhe në nenin 6 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, për një proces të hapur dhe të rregullt, që çdo person i akuzuar ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, duke pasur parasysh edhe bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij, si dhe në parimin që çdo person i akuzuar për një veprë penale të prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht.

Pasi që, të dëmtuarit: M.S., M.K., M.A., A.M., A.Sh.H. dhe B.J., gjatë deklaramit të tyre në mundësinë hetuese të veçantë kanë deklaruar se nuk ndihen të dëmtuar në raport me të akuzuarin dhe nuk kërkojnë kompensim dëmi, të njëjtit nuk janë udhëzuar në kontest civil.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e prokurorit të shtetit se sendet si në dispozitiv të këtij aktgjykimi janë përdorur për kryerjen e veprës penale apo përfituar me veprë penale, mirëpo me asnjë provë formale e as materiale nuk është vërtetuar se i akuzuari si më lart këto sende i ka përdorur për kryerjen e veprës penale apo i ka përfituar me veprë penale.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, u mor në bazë të nenit 453, par.1 të KPP.

Nga sa u tha më lart, dhe në bazë të nenit 363, par. 1, nënpar. 1.3 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ky aktgjykim është përpiluar me datë 16.11.2023.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/ DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA
PKR.nr.408/2022, datë 10.11.2023.

Bashkëpunëtoreshë profesionale
Arbenita Hoxha Koleci

Kryetari i trupit gjykues
Naser Foniqi

UDHËZIMI PËR MJETET JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi, ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar **brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh**, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.